

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN
PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9774, DATË
12.7.2007 "PËR VLERËSIMIN DHE ADMINISTRIMIN E ZHURMËS
NË MJEDIS", I NDRYSHUAR¹

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është përmirësimi i parashikimeve të ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", të ndryshuar, nëpërmjet ndarjes së qartë të kompetencave midis institucioneve qendrore dhe vendore për monitorimin e nivelit të zhurmës në zona publike apo të gjeneruar nga veprimtari ekonomike ose sociale, si dhe dhënien e miratimeve për zhvillimin e aktiviteteve që lëshojnë zhurmë në mjedis, duke siguruar që zhurma e lejuar të jetë brenda vlerave kufi, me objektiv madhor për ta bërë Shqipërinë një vend që plotëson standartet Evropiane për administrimin e zhurmës dhe duke ngritur sistemin bazë për të raportuar në lidhje me hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit për zhurmën.

Bazuar në kompetencat që ligji i jep, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka marrë përsipër të propozojë një plan masash për reduktimin, parandalimin deri në ndalimin e plotë në zona specifike të burimeve të zhurmës mbi vlerat kufi. Monitorimi dhe parandalimi i lëshimit të zhurmës mbi vlerat kufi, si një masë për parandalimin e mbrojtjes së mjedisit dhe njerëzve nga zhurmat e bezdisshme, pritet që të sjell një reduktim të zonave ku zhurma përbën një problem serioz për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve, dhe si rrjedhojë do të sjell minimizim të ndikimit në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

Zhurmë mjedisore është çdo tingull, i padëshiruar apo i dëmshëm, i lëshuar nga veprimtaritë njerëzore, përfshirë zhurmën e lëshuar nga mjetet e transportit, nga trafiku rrugor, hekurudhor, ajror dhe nga sheshet ku zhvillohen veprimtari industriale, etj. Gjenerimi i zhurmave ka efekte negative në shëndetin e njeriut, si dhe në mjedis dhe për këtë duhen marrë masa mbrojtëse për zvogëlimin e nivelit të zhurmave në mjedis nëpërmjet ndërhyrjeve dhe të veprimeve, që merren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin e ndikimit të saj negativ, duke e sjellë atë në nivelin kufi. Burimet e zhurmave në mjedis mund të jenë të

¹Relacion për Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", të ndryshuar.

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN
PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9774, DATË
12.7.2007 "PËR VLERËSIMIN DHE ADMINISTRIMIN E ZHURMËS
NË MJEDIS", I NDRYSHUAR¹

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është përmirësimi i parashikimeve të ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", të ndryshuar, nëpërmjet ndarjes së qartë të kompetencave midis institucioneve qendrore dhe vendore për monitorimin e nivelit të zhurmës në zona publike apo të gjeneruar nga veprimtari ekonomike ose sociale, si dhe dhënien e miratimeve për zhvillimin e aktiviteteve që lëshojnë zhurmë në mjedis, duke siguruar që zhurma e lejuar të jetë brenda vlerave kufi, me objektiv madhor për ta bërë Shqipërinë një vend që plotëson standartet Evropiane për administrimin e zhurmës dhe duke ngritur sistemin bazë për të raportuar në lidhje me hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit për zhurmën.

Bazuar në kompetencat që ligji i jep, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka marrë përsipër të propozojë një plan masash për reduktimin, parandalimin deri në ndalimin e plotë në zona specifike të burimeve të zhurmës mbi vlerat kufi. Monitorimi dhe parandalimi i lëshimit të zhurmës mbi vlerat kufi, si një masë për parandalimin e mbrojtjes së mjedisit dhe njerëzve nga zhurmat e bezdisshme, pritet që të sjell një reduktim të zonave ku zhurma përbën një problem serioz për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve, dhe si rrjedhojë do të sjell minimizim të ndikimit në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

Zhurmë mjedisore është çdo tingull, i padëshiruar apo i dëmshëm, i lëshuar nga veprimtaritë njerëzore, përfshirë zhurmën e lëshuar nga mjetet e transportit, nga trafiku rrugor, hekurudhor, ajror dhe nga sheshet ku zhvillohen veprimtari industriale, etj. Gjenerimi i zhurmave ka efekte negative në shëndetin e njeriut, si dhe në mjedis dhe për këtë duhen marrë masa mbrojtëse për zvogëlimin e nivelit të zhurmave në mjedis nëpërmjet ndërhyrjeve dhe të veprimeve, që merren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin e ndikimit të saj negativ, duke e sjellë atë në nivelin kufi. Burimet e zhurmave në mjedis mund të jenë të

¹Relacion për Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", të ndryshuar.

shumta, aktivitetet e shërbimit social që gjenerojnë zhurma nëpërmjet muzikës (bare, restorante, pabe, disko), si dhe makineritë dhe pajisjet e ndryshme në ambientet e jashtme.

Çdo shtetas ka të drejtë të mbrohet dhe të përfitojë mbrojtje nga organet shtetërore nga efektet e dëmshme të zhurmës mjedisore. Mbrojtja zbatohet për zhurmën, ndaj së cilës njerëzit ekspozohen në mjedisin ku ndodhen, në zona të banuara, në mjediset e institucioneve publike, në parqe publike dhe hapësira të tjera, të qeta, çlodhëse, në zona të qeta në natyrë, në institucionet për fëmijë, institucione shëndetësore, arsimore, kulturore, fetare dhe në mjedise të tjera të ngjashme me to të cilat tejkalojnë nivelin e zhurmës që është përcaktuar si i lejueshëm për secilën nga zonat. Kur tejkalohe nivelin e zhurmave, organet shtetërore janë të detyruara të shqyrtojnë situatën dhe të kërkojnë marrjen e masave për zbutjen e atyre zhurmave. Masat konkrete ndërmerren në bazë të matjes, llogaritjeve dhe monitorimeve të nivelit të zhurmës.

Rregullat kryesore për menaxhimin e qëndrueshëm të zhurmave në mjedis përcaktohen në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis dhe direktivave europiane", të ndryshuar, që rregullojnë nivelet e lejuara të zhurmave nga burimet e mësipërme dhe traspozon pjesërisht (Direktivën 2002/49/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 qershor 2002 në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore), si dhe direktivava apo rregullore të tjera që përcaktojnë kërkesa specifike për zhurmat e gjeneruara nga sektorë të tjerë, siç është transporti rrugor, ajror, hekurudhor, zhurmat e gjeneruara nga pajisjet dhe makineritë, si dhe zhurmat e gjeneruara nga sektori i shërbimeve publike (restorante, bare, disko etj.).

Edhe pse ka një bazë ligjore të miratuar, zhurmat ngelen akoma një problem serioz në zonat urbane apo ato turistike, duke u kthyer në shqetësim serioz për popullatën. Ndër problemet kryesore për administrimin e zhurmës, monitorimin e saj dhe mbajtjen në kontroll të saj, është mos ndarja qartë e kompetencave ndërmjet institucioneve apo mbivendosja e kompetencave. Zhurmat e lëshuara mbi nivelet kufi të përcaktuara në legjislacionin përkatës kanë ndikim negativ në mjedis dhe shëndetin e njerëzve. Për më tepër, në ekonomi dëmet e shkaktuara nga zhurma mbi nivelet kufi janë shumë të mëdha duke ndikuar drejtpërsëdrejti në turizmin dhe jetën e përditshme të qytetarëve. Mbrojtja e mjedisit dhe e shëndetit të njeriut nga pasojat e lëshimit të zhurmës mbi nivelet kufi janë në politikën e qeverisë për të siguruar një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, si dhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe

Relacion për Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", të ndryshuar.

në veçanti nxitjen e zhvillimin e ekonomisë së turizmit dhe promovimit të përdorimit me efikasitet të burimeve natyrore.

Objektivat e këtij projektligji janë:

- Ndarja e qartë e kompetencave dhe përgjegjësiwe institucionale midis institucioneve qendrore dhe atyre vendore mbi monitorimin e nivelit të zhurmës në mjedis dhe kontrollin; Sigurimi nga njësitë e vetqeverisjes vendore i përmbushjes së kritereve teknike të ushtrimit të aktiviteteve të reja ekonomike/turistike dhe atyre ekzistuese që gjenerojnë zhurma në mjedis brenda nivelit të lejuar të zhurmës dhe vlerave kufi;
- Garantimi i përmirësimit të funksioneve të inspektimit nga stukturat përgjegjëse të kontrollit/monitorimit të zhurmës në mjedis;
- Garantimi i cilësisë së monitorimit, të matjeve, të zbatimit të metodikave nëpërmjet pajisjeve të çertifikuara për matjen e niveleve të zhurmës;
- Kontribuimi në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë për të raportuar mbi zbatimin e standardeve europiane për administrimin e zhurmës në zbatim të direktivës përkatëse të BE-së;
- Forcimi i zbatimit të kërkesave ligjore nga subjektet fizikë/juridikë të cilët ushtrojnë veprimtari që gjenerojnë zhurmë mbi nivelin e lejuar të saj.
- Ashpërsimi kundravajtjeve të parashikuara në nenin 32 të ligjit të zhurmave.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është i parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2023 dhe është në përputhje me politikën e qeverisë për të siguruar një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm si dhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe në veçanti nxitjen e zhvillimin e ekonomisë së turizmit dhe promovimit të përdorimit me efikasitet të burimeve natyrore.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Relacion për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij projektligji do të garantohet mbrojtja e mjedisit dhe e shëndetit të njeriut nga pasojat e lëshimit të zhurmës mbi nivelet kufi, e cila do të sjellë minimizim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

Ndotja e zhurmave ndikon në shëndetin psikologjik, mund të shkaktojë hipertension, nivele të larta të stresit, tringëllimë në veshët, humbje të dëgjimit, shqetësime gjumi dhe efekte të tjera të dëmshme. Nivelet e larta të zhurmës mund të rezultojë në efekte kardiovaskulare dhe ekspozimi ndaj niveleve të moderuar të larta gjatë një periudhe të vetme tetëorëshe shkakton një rritje statistikore në presionin e gjakut prej pesë deri në dhjetë pikë dhe një rritje në stres. Shkakton rritjen e incidencës së sëmundjes së arteries koronare .

Nga informacionet e mbledhura nga institucionet ku adresohen ankesat e qytetarëve/bizneseve/turistëve. Rezulton si mëposhtë:

Në AKM/ DRM (struktura inspektuese në mjedis) janë regjistruar mbi 50 ankesa shkresore këtë sezon veror për nivelin e lartë të zhurmës në mjedis, ndërsa referuar informacionit të përcjellë nga Ministria e Brendshme rezulton që ka një numër të lart ankesash nga qytetarët për ndotjet akustike kryesisht në zona urbane dhe ato turistike.

Një sërë raportesh të hartuara nga institucione apo organizata ndërkombëtare apo edhe kombëtare kanë evidentuar problematikën e administrimit jo të duhur të zhurmës, si më poshtë vijon:

- Referuar progres raporteve të BE-së për Shqipërinë të 5 viteve të fundit 2017-2021, përsa i përket çështjes së zhurmës, gjithnjë citohet se Shqipëria duhet të forcojë kapacitetin e saj administrativ për përgatitjen e hartave strategjike të zhurmës dhe planeve të veprimit.
- Rishikimi i Performancës së Mjedisit (EPR): Shqipëri, Rishikimi i Tretë (UN, 2018) në rekomandimin 2.5 citohet se: “Qeveria duhet të miratojë standardet e cilësisë dhe të shkarkimeve për ajrin, ujin, tokën dhe zhurmën, duke marrë parasysh standardet dhe udhëzimet e pranuar ndërkombëtarisht:.
- Referuar RGJM 2021, vërehet se kemi tejkalimin të normës ditën (55 dB) në të gjitha qytetet, duke përjashtuar qytetin e Kukësit, i cili është nën normën e lejuar. Niveli më i lartë i zhurmave është vlerësuar në stacionet e Tiranës ku kemi tejkalim të normës në masën 15.2%. Gjithashtu, kemi tejkalimin të normës natën (45 dB) në të gjitha qytetet, përveç qytetit të Kukësit. Niveli më i lartë është monitoruar në stacionet e Tiranës me një tejkalim në shkallën 17.88%.

- Raporti Përfundimtar i KLSH Auditimi Performance “NDOTJA AKUSTIKE” i vitit 2019 konkludon se Masat e marra nga MTM dhe MSHMS, si dhe Bashkia Tiranë, për manaxhimin e zhurmave mjedisore në vendin tonë nuk kanë qenë efektive. Për më tepër ko konstatuar se institucionet inspektuese për zhurmen kanë mungesë të aparaturave matëse të zhurmave, e cila bën të pamundur procesin e inspektimit ndaj tejkalimit të normave të lejuara të zhurmave mjedisore.
- Referuar raportit Mushkëri të Gjelbra për Qytetet Tona, 2021, nga Coplan, citon se si rezultat i matjeve të kryera gjatë viteve 2018-2021, rezulton se të dhënat për ndotjen e zhurmës konfirmojnë se tejkalojnë standardin e lejuar si gjatë paradites edhe gjatë mbrëmjes. Në total, vlerësohet se mbi gjysmë milion qytetarë të Republikës së Shqipërisë, operojnë çdo ditë nën ekspozimin dhe ndikimet e zhurmave dhe ndotësve të ajrit. Rëndësia e monitorimeve dhe përmirësimi i pritshëm i situatës është një emergjencë që prej vitit 2000. Toleranca korruptive dhe e ndëshkueshme ndaj detyrimeve ligjore për menaxhimin e shëndetit mjedisor urban po shkakton degradim të cilësisë së jetës dhe të shëndetit të banorëve të qyteteve të mëdha në Shqipëri.

Këto të dhëna tregojnë se ndotja nga zhurma përbën një prej ndotësve kryesore të mjedisit shqiptar dhe kryesisht zonave urbane dhe turisitke, si në shtrirje territoriale ashtu dhe në sasi, duke treguar se masat për të gjetur një zgjidhje definitive janë sa të nevojshme, të justifikuara aq edhe emergjente. Ka zona në qytete e mëdha të vendit, apo zona turistike, sic është përshembull rasti i zonës së ish-bllokut, ku ndotja akustike mbetet po aq problematike, për shkak të muzikës së lartë në lokalet e shumta që frekuentohen kryesisht nga grupmoshat e reja. Oraret e muzikës janë kufizuar dhe pas mesnate dhe është thuajse qetësi. Megjithatë, para kësaj ore ka shumë lëvizje dhe shpeshherë kalon nivelet kufi.

Sa më lart, që ligji të realizojë plotësisht qëllimet për të cilat është miratuar dhe zgjidhjet e ofruara për menaxhimin e zhurmës në Republikën e Shqipërisë, të garantojnë sa më tepër rezultate positive, janë propozuar ndryshimet e parashtruara në projektligjin e hartuar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Relacion për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar.

Ky projektligj është hartuar në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe në harmoni me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, si ligj kuadër.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji përfron plotësisht Direktivën 2002/49/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 qershor 2002 në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore - Deklarata e Komisionit në Komitetin e Pajtimit mbi Direktivën në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore, Fletorja Zyrtare L 189, 18/07/2002 F. 0012 – 0026, 02002L0049 — EN — 29.07.2021 — 006.001.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në nenin 1 të këtij projektligji parashikohet zëvendësimi i disa termave, duke e azhornuar me ndryshimet e akteve ligjore në fuqi.

Në nenin 2 të këtij projektligji parashikohet që në pikën 2 të nenit 2, pas fjalës “..miratojnë” të bëhet shtimi i fjalëve “orarin dhe..”, me qëllim që Udhëzimi nr. 8 datë 27.12.2007, “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” të rishikohet duke përfruar përcaktimet më të fundit në aktet ndërkombëtare për nivelet kufi të zhurmës, duke qenë se kanë kaluar 15 vite nga data e miratimit të Udhëzimit të sipër cituar dhe *Acquis* i BE-së është gjithnjë në proces rishikimi dhe përmirësimi, por edhe të përcaktojë oraret në varësi të niveleve kufi të zhurmës.

Në nenin 3 të këtij projektligji parashikohet shtimi i pikës 20, 21 dhe 22, në nenin 3 të ligjit ekzistues, ku parashikohet shtimi i tre terma, përkatësisht “Aglomerat, i cili është term i përcaktuar në direktive dhe përbën përfrim me këtë direktivë për sa i përket këtij termi, “Zonë turisite”, si dhe “Vërtetim”, i cili është dokumenti që parashikohet të lëshohet nga bashkia mbi plotësimin e kushteve për lëshuesit e zhurmës mbi nivelet kufi të lejuara. Lëshimi i vërtetimit nga bashkia është një koncept i ri që propozohet nga ky projektligj dhe synohet mbajtja në kontroll e nivelit të zhurmës nga aktivitetet që janë burim zhurme në mjedis.

Relacion për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar.

Në nenin 4 të këtij projektligji parashikohet një riformulim i pikës 1 dhe 2 të nenit 5 të ligjit ekzistues me qëllim mirë përcaktimin e përgjegjësive të MTM dhe MSHMS, si dhe përcaktimi i detyrimeve që kanë institucionet e tyre të varesisë, përkatësisht AKM-ja dhe ISHP-ja.

Në nenin 5 është parashikuar shfuqizimi i 4 neneve të ligjit ekzistues, pasi përcaktimet në këto nene nuk janë më koherente, përkatësisht është shfuqizuar:

- neni 6 që përcaktonte ngritjen e Këshillit Teknik për Zhurmat, i cili ka rezultuar si nen i pa zbatueshëm për këto 15 vite, që nga miratimi i ligjit ekzistues në vitin 2007. Për më tepër në këtë nen parashikohet që ky Këshill Teknik të kishte rol vetëm këshillimor dhe jo vendimarrës, ndaj dhe nuk është krijuar deri më sot ky Këshill. me propozimet që sjell lky projekt ligj, detyrat dhe kompetencat ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore do të jenë të qarta, si pasojë, akoma dhe më shumë në ditët e sotme, nuk lind nevoja që të ngrihet një organ Këshillimor.
- neni 7, që përcaktonte krijimin e sektorit të zhurmave në ISHP, është një përcaktimit i cili është zbatuar dhe nuk është më e nevojshme të krijohet më një sektor i tillë. Për më tepër, në riformulimin që propozohet në bëhet në pikën 2 të nenit 5 të ligjit ekzistues, përcaktohet përgjegjësia dhe detyrimet që ka ISHP-ja, ku i jepet detyrë konkrete sektorit të zhurmave në ISHP për vlerësimin e ndikimeve negative të zhurmës në shëndetin e njeriut.
- neni 22 dhe 23 (kreu V) propozohen të shfuqizohen, pasi në 15 vite nuk janë zbatuar. Neni 22 që përcaktonte certifikimin dhe testimin e ekspertit të zhurmës nuk është zbatuar pasi nuk ka kritere të mirë përcaktuara as në legjislacion apo metodologji kombëtare sikurse ndërkombëtare për dhënien e statusit të ekspertëve të zhurmës, dhe si rrjedhojë edhe neni 23 nuk mund të zbatohet. Gjithashtu, vlen të theksohet edhe fakti që detyrat e ekspertit të zhurmës, që pas krijimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit në nëntor të vitit 2007, pra pas miratimit të ligjit nr. nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, si dhe bërjen funksionale të DPA-së pas miratimit të VKM nr. 1716, datë 03/10/2008 e kryejnë organet e akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet e tregtisë (MFE). Këto organe janë të akredituar për të kryer matje e vlerësime të zhurmës. Matja apo vlerësimi i zhurmës nuk mund të kryhet nga individë apo ekspertë për zhurmën, por vetëm nga organe të akredituara, që të jenë në përputhje me S SH ISO/IEC 17025 “Kërkesa të Përgjithshme për Kompetencën e Laboratorëve Testues dhe Kalibrues” dhe SSH EN ISO/DIS 1996 “Akustika Përshkrimi, matja dhe vlerësimi i zhurmës mjedisore - Pjesa 2: Përcaktimi i

Relacion për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar.

niveleve të presionit të zërit”. Mosakreditimi i procesit të monitorimit të zhurmave ndikon gjithashtu në besueshmërinë të ulët të të dhënave. Referuar të dhënave nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, rezulton se laborator (organi i akredituar) i parë për matjen dhe vlerësimin e zhurmës mjedisore në shqipëri është akredituar në vitin 2011. Aktualisht në Shqipëri raportet e vetëmonitorimit për subjektet që zotërojnë leje mjedisore për zhurmat, kryhen nga ekspertë mjedisorë të cilët disponojnë laboratorë të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, ndaj ky fakt duhet reflektuar edhe në këtë projektligj të propozuar, duke shfuqizuar nenin 22 dhe 23.

Në nenin 6 është parashikuar ndryshimi i nenit 8 të ligjit ekzistues duke riformuluar detyrat e NJVV-ve, me qëllim mirë përcaktimin e përgjegjesive të NJVV-ve. Përveç detyrimeve për kryerjen e hartëzimit të zhurmës dhe planeve vendore dhe zbatimit të tyre apo shpalljen e zonave të qeta në territorret brenda juridiskionit të tyre, i u përcaktohet edhe detyrimi për lëshimin e vërtetimit mbi plotësimin e kushteve teknike për gjenerimin e zhurmave brenda niveleve kufi. Për më tepër i përforcohet e drejta për kontroll, matje, pezullim apo mbyllje të veprimtarive, që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji, si dhe të cilat referuar legjislacionit në fuqi nuk është e nevojme të pajisen me leje mjedisi).

Në nenin 7 është parashikuar shtimi i një gërme në nenin 9 ekzistues, ku ndër masat e tjera për mbrojtjen nga zhurma, përcaktohen edhe oraret për ushtrimin e veprimtarive ekonomike, industriale, sociale, kulturore, argëtuese si masë për mbrojtjen nga zhurma.

Në nenin 8 janë parashikuar një sërë ndryshimesh në nenin 12 ekzistues, ku riformulohet pika 2 me qëllim përcaktimin e lëshimit të vërtetimit nga bashkia për personat fizikë dhe juridik, veprimtaritë e të cilëve lëshojnë zhurmë në mjedis, mbi plotësimin e kushteve teknike për gjenerimin e zhurmave, si dhe përcaktimi i afatit që brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, pajisen me vërtetim të gjithë personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë veprimtaritë e caktuara.

Në nenin 9 është parashikuar ndryshimi i pikës 4 të nenit 18 ekzistues me qëllim ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë nga personat fizikë dhe juridik pa u pajisur paraprakisht me vërtetim nga bashkia përkatëse.

Në nenin 10 janë parashikuar një sërë ndryshimesh në nenin 20 ekzistues, ku riformulohet pika 4 me qëllim të përcaktohet detyrimi i hartëzimit dhe hartimi/miratimi i planeve vendore të veprimit në harmonizim me planet e përgjithshme vendore, si dhe shtimi i pikave 5, 6 dhe 7. Në këtë nen bëhet edhe një pjesë e perafimit me direktivën e BE-së, pasi direktiva kërkon që vendet e BE-së të përgatisin dhe publikojnë hartat e zhurmës dhe planet e veprimit për

Relacion për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar.

menaxhimin e zhurmës çdo 5 vjet, ndaj në pikën 4 përcaktohet detyrimi për të miratuar plane veprimi për zonat pranë “rrugë kryesore”, “hekurudhë kryesore” dhe “aeroport kryesor civil”, si dhe në pikën 5 përcaktohet detyrimi për të rishikuar këto plane çdo 5 vite nga data e miratimit të tyre. Në pikën 6 është parashikuar detyrimi që bashkia ka që të konsultohet me publikun gjatë hartimit të planeve të veprimi për menaxhimin e zhurmës, i cili është një parashikim i direktivës së BE-së, ku përcaktohet qartë se kur hartojnë plane veprimi për menaxhimin e zhurmës, autoritetet kombëtare duhet të konsultohen me publikun e interesuar. Në pikën 7 përcaktohet detyrimi për raportim për zbatimin e këtyre planeve për të evidentuar se sa efikas ka qenë plani për parandalimin dhe reduktimin e zhurmës mjedisore, si dhe për ruajtjen e cilësisë së zhurmës mjedisore në zonat ku është brenda normave.

Në nenin 11 është parashikuar ndryshimi pikës 2 të nenit 21 ekzistues, me qëllim përcaktimin e detyrimit për bashkinë të bëjë publike hartën strategjike dhe të jetë e aksesueshme për publikun, sikurse përcaktohet edhe në direktivën e BE-së dhe është një ndër katër fushat e verpimit të direktivës.

Në nenin 12 është parashikuar riformulimi i pikës 3 të nenit 24 ekzistues me qëllim heqjen e detyrimit që vetmonitorimi i zhurmës në mjedis realizohet nga ekspertë të certifikuar.

Në nenin 13 është parashikuar ndryshimi i pikës 1 të nenit 25 ekzistues me qëllim mirë përcaktimin e përgjegjësisë për kryerjen e matjeve për nivelin e zhurmës midis AKM-së dhe bashkisë. Përkatësisht, AKM-ja është autoriteti përgjegjës për matjet për nivelin e zhurmës për instalimet e pajisura me leje mjedisi në rast kontrolli dhe verifikimi, si dhe bashkia është autoriteti përgjegjës për matjet për nivelin e zhurmës për aktivitetet e pajisura me vërtetim në rast kontrolli dhe verifikimi.

Në nenin 14 është parashikuar riformulimi i gërmës “a” të nenit 28 ekzistues me qëllim shtimin e detyrimit se, edhe aktivitetet e pajisura me vërtetim nga bashkia janë objekt kontrolli për zbatimin e dispozitave të këtij ligji e të akteve nënligjore.

Në nenin 15 është parashikuar riformulimi i pikës 1 me qëllim mirë përcaktimin e organeve të kontrollit. Referuar gjithë frymës së projektligjit për ndarjen e kompetencave, kompetenca për kontrollin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe i akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij, kryhet nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit, struktura përgjegjëse në bashki dhe Struktura përgjegjëse për kontrollin e automjeteve. Nëpërmjet këtij riformulimi i është hequr e drejta për kontroll Inspektoriatit që mbulon fushën e shëndetit, pasi është vetëm ISHP-ja që kryen vlerësimin e ndikimeve negative të zhurmës në

Relacion për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar.

shëndetin e njeriut referuar matjeve të kryeara nga AKM-ja, bashkia apo organet e akredituara, ose në raste studimore mund të kryeje matje vete ISHP-ja, si dhe Inspektoratit që mbulon fushën e punës, pasi ky ligj nuk zbatohet për brenda vendeve të punës. Për administrimin e zhurmës në vendet e punës zbatohen rregullat, kërkesat dhe masat e miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon shëndetësinë dhe të ministrit që mbulon punën.

Në nenin 16 janë parashikuar ndryshime në nenin 32 ekzistues, i cili parashikon “Kundërvajtjet administrative”, duke shtuar si shkelje administrative mospajisjen me vërtetim të bashkisë për veprimtari të cilat gjenerojnë zhurmë në përputhje dhe me ndryshimet e propozuara në këtë projektligj.

Gjithashtu, është rishikuar për disa kundravajtje administrative masa e gjobës në propocion me pasojat që sjell ndotja akustike në shëndet dhe mjedis, si dhe në përcaktimin e masës së gjobës është mbajtur në konsideratë edhe masa e dënimit për kundravajtje të tjera administrative në fushën e mjedisit. Po ashtu, kundërvajja e parashikuar në gjermën “dh” është shfuqizuar, pasi nuk gjen zbatim, si dhe është parashikuar se gjoba e vendosur për kundravajtjet e parashikuara në këtë ligj përbën titull ekzekutiv dhe paguhet brenda periudhës së përcaktuar në legjisllacionin në fuqi, me qëllim bërjen e zbatueshën të kundravajtjes administrative.

Në nenin 17 është parashikuar hyrja në fuqi e ligjit 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij akti ngarkohen:

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin dhe institucionet e saj të varësisë
2. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionet e saj të varësisë
3. Bashkia / Policia Bashkiake

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e projektligjit kanë kontribuar ekspertë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit si dhe ekspertë të projektit SANE27, faza II.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka hedhur projektligjin e propozuar në faqen e regjistrimit elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJK, më datë

Relacion për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar.

27.10.2022 duke i dhënë mundësi publikut, grupeve të interesit dhe komunitetit të biznesit të shprehin mendimet e tyre.

Ndërkohë që MTM i është drejtuar edhe me shkresë zyrtare nr. 8314 prot, datë 11.11.2022, 61 bashkive të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin e tyre mbi këtë projektligj dhe ndryshimet ligjore të këtij propozimi. Komentet e disa bashkive janë marrë në konsideratë që lidhen kryesisht me përcaktimin dhe ndarjen e qartë të detyrave të inspektimit të strukturave pranë AKM/ARM dhe atyre të inspektimit në Bashki.

Gjithashtu, MTM ka organizuar dhe dëgjesën publike me grupet e interesit pranë ambienteve të ministrisë në datë 16.1.2023, ora 10.00, ku u diskutua nga të pranishmit projektligji, synimet dhe objektivat e tij. Grupet e interesit e mbështetën nismën për qartësimin e kompetencave duke përfshirë bashkitë në procesin e kontrollit, si autoritete kompetente brenda territorit të së cilës ushtrohen këto veprimtari. Komentet dhe sugjerimet e tyre u trajtuan dhe reflektuan në draftin e projektligjit, të konsoliduar, ku u vu theksi kryesisht për marrjen e masave mbrojtëse nga niveli i lartë të zhurmës mbi atë kufi të lejuar në zonat turistike në bregdet, si dhe në harmonizimin e planeve të menaxhimit të zhurmave me PPV-në e secilës bashki. Theksi u vendos edhe tek afati kohor i hartimit të planeve vendore të veprimit për zhurmat dhe bazuar në diskutime u dakordësua që këto plane të harton 1 vit pas përgatitjes së hartave strategjike të zhurmës. Reflektimi u pasqyrua në nenin 10, pika 1 e projekt ligjit.

Projektligji do dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrin të Shtetit dhe Kryenegociator, Ministrinë e Kulturës si edhe në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji do të sjellë ndikim në buxhetin e shtetit, të cilat lidhen kryesisht me:

- Kosto për përmirësimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të zhurmës në mjedis nga AKM/ bashkitë nëpërmjet blerjes së pajisjeve të certifikuara për matjen e nivelit të zhurmës, sikurse kërkohet nga standarti ndërkombëtar ISO si dhe kostoja për akreditimin e tyre nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit. Kostoja për blerjen e një pajisje të

certifikuar shkon përfaqësisht në vlerën 800.000 (shtatëqind e pesëdhjetëmijë) lekë.

- Kostot e vazhdueshme që lidhen me:
 - Mbarëvajtjen e sistemit të monitorimit të zhurmës dhe vlerësimit në mjedis që lidhet me koston vjetore të procesit të akreditimit të pajisjeve të blera që shkon përfaqësisht 200.000 (dyqindmijë) lekë;
 - Mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të përftuara nga monitorimi i zhurmës në mjedis;
 - Hartimin nga bashkitë të hartave të zhurmës;
 - Hartimin e planeve vendore për menaxhimin e zhurmës;
- Të ardhurat që vijnë nga vjelja e gjobave si sanksion administrativ, si për buxhetin e shtetit për shkak të inspektimit nga struktura përgjegjëse e inspektimit pranë AKM-së, ashtu edhe për buxhetin e bashkive, nëpërmjet kryerjes së inspektimeve si rezultat i qartësimit të kompetencave të parashikuara në këtë projektligj.

Përlllogaritja e efektit financiar është e detajuar në aneksin 1A të dokumentit të raportit të vlerësimit të ndikimit që është bashkëlidhur projektligjit të propozuar.

MINISTËR



MIRELA KUMBARO